



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 305 /2024

Datë: 23.12.2024

Agjencia për Informim dhe Privatësi, zyrtari i inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafin 1.1 dhe 1.6, si dhe nenin 99 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas inspektimit sipas detyrës zyrtare të realizuar në “Kolegji Universum” O.P., nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë kundërvajtëse me vlerë prej 8,000.00 € (tetë mijë euro), ndaj “Kolegji Universum” O.P, NUI: 810640294, Ferizaj, në cilësinë e kontrolluesit për shkeljen e dispozitave të përgjithshme për vëzhgimin me kamerë.
2. Urdhërohet “Kolegji Universum” O.P., NUI: 810640294, Rr. “Haki Stërmilli” Ferizaj, në cilësinë e kontrolluesit të largoj sistemin e vëzhgimit me kamerë të vendosur në sallat e ligjërimit, tualete përkatësisht tek pjesa e lavamanit.
3. Urdhërohet Kontrolluesi, që vëzhgimin me kamerë ta aplikoj sipas dispozitave ligjore të parapara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Obligohet Kolegji Universum O.P.810640294, Ferizaj, që shumën e përcaktuar nga pika 1 e këtij vendimi ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në xhirollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga përmbartuesi privat.
6. Obligohet kontrolluesi që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit ta zbatojë atë dhe të njoftojë Agjencinë.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ar sy e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 29.11.2024, ka pranuar një njoftim përmes postës elektronike (e-mail) që mbanë numrin e protokollit 1083, të parashtruar nga subjekti i të dhënave, që pretendon se në Kolegjin Universum, përkatësisht në shkollën e mesme të ulët në Ferizaj, janë vendosur kamera në sallat e ligjërimit dhe në tualete përkatësisht tek lavamani. Si nxënësit, po ashtu edhe mësimdhënësit, përgjatë gjithë procesit mësimor janë nën mbikëqyrjen e kamerave.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia përmes zyrtarëve të inspektimit, më datë 10.12.2024, ka realizuar inspektim sipas detyrës zyrtare tek kontrolluesi “Kolegji Universum” në Ferizaj, për të vërtetuar pretendimet e palës njoftuese. Gjatë inspektimit, është hartuar procesverbali në formë elektronike me Nr. 27/2024, dhe është konstatuar kjo gjendje faktike: “kontrolluesi ka të vendosura kamera në klasa mësimore për nxënës të shkollës së mesme të ulët, gjithashtu kamerat janë të vendosura dhe para tualeteve përkatësisht tek pjesa e lavamanit. Kontrolluesi ka të vendosura gjithsejtë njëzetë e pesë (25) kamera, nga të cilat katërmbëdhjetë janë funksionale. Kontrolluesi nuk ka të nxjerr vendim për instalimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, ka të vendosura shenja njoftuese në hyrje të objektit, të cilat nuk janë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Afati i ruajtjes së regjistrimeve nga sistemi i vëzhgimit me kamerë është tri (3) ditë. Qasja në kamera ka zyrtari i teknologjisë informative brenda Kolegjit dhe hapësirat e monitorimit janë të mbyllura me çelës dhe nuk monitorohen në çdo kohë”.

Procesverbali është dërguar me datë 13.12.2024 në formë elektronike me qëllim të dhënies së komenteve. Më pas, më datë 16.12.2024, nga kontrolluesi kemi pranuar komentet në të cilën është theksuar se: “Ashtu siç është theksuar në procesverbalin e inspektimit, ne kemi vendosur kamera në klasa mësimore për nxënës të shkollës së mesme të lartë (klasa 10), si dhe kamera PARA tualeteve (në korridorin para tyre, që nuk cenon privatësinë e askujt që ndodhet brenda tualetit), përkatësisht tek pjesa e lavamanit, me qëllimin e vetëm që të parandalohen veprimet destruktive që rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve (siç kishim rastet e javëve të fundit të lojërave të rrezikshme nga motivuara nga tik-toku. Tek tualetet - është e rëndësishme të theksohet se struktura e ndërtimit të tyre është e hapur nga pjesa e sipërme (tavani) dhe kishim raste kur nxënësit pinin duhan dhe mbushej e gjithë hapësira me tym”.

Në Republikën e Kosovës e Drejta e Privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë, Marrëveshje dhe instrumente Ndërkombëtare dhe me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo e drejtë, e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (KRK), përfshin respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Neni 36, paragrafi 4 i KRK-së, i kushtohet mbrojtjes së të dhënave personale, përkatësisht të dhënave për personin. Kjo e drejtë paraqet një nga të drejtat e reja të mbrojtjes së privatësisë së individit. Kushtetuta përcakton se vetëm me ligj mund të rregullohet grumbullimi, mbajtja, qasja, përmirësimi dhe shfrytëzimi i të dhënave për personin. Gjithashtu kjo e drejtë është e garantuar edhe me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

ku çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij, e cila sipas neni 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejtë në vendin tonë. LMDHP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LMDHP-së, me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, vëzhgimi me kamerë nënkupton marrjen dhe ruajtjen e të dhënave vizuale ose të tjera nga vendet e vëzhguara, ku personat fizikë lëvizin, përmes sistemit të instaluar të vëzhgimit me kamerë. Për më tepër, vëzhgimi me kamerë nënkupton përpunimin e të dhënave personale gjatë regjistrimit të një personi fizik, në përputhje me përkufizimin e përpunimit të të dhënave personale të parashikuara në LMDHP. Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, LMDHP në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LMDHP 2 së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se mbledhja dhe regjistrimi i imazheve të marra nga sistemi i vëzhgimit me kamerë, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme. LMDHP parasheh parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale. Njëri nga këto parime është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, në bazë të të cilit të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDHP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin. Përpunim i të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë është i rregulluar në kreun XVI të LMDhP-së. Neni 76, paragrafi 1 i LMDHP-së, përcakton se personat në sektorin publik dhe privat mund të instalojnë sistemet e vëzhgimit me kamerë për vëzhgimin e ndërtesave të tyre nëse konsiderohet e nevojshme për sigurinë e njerëzve dhe sigurimin e pasurisë, nëse nuk mund të arrihet me mjete tjera më të lehta. Vëzhgimi me kamerë, në veçanti, mund të jetë i nevojshëm për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve. Gjithashtu, neni 78, paragrafi 1 i LMDhP-së, i cili rregullon vëzhgimin me kamerë në sektorin e punësimit, ka përcaktuar kriteret e njëjta kur mund të instalohet ky sistem, e që është siguria e njerëzve, siguria e pronës, por edhe në raste të caktuara siguria e informacioneve konfidenciale. Pra, qëllimi kryesorë kur mund të instalohet sistemi i vëzhgimit me kamerë është siguria e njerëzve dhe siguria e pasurisë, kur nuk mund të arrihet me mjete tjera, me të cilën na lenë të kuptojmë që nëse mund të arrihet me mjete tjera

edhe vëzhgimi me kamerë në raste të caktuara mund të kufizohet. Në rastet kur kontrolluesi vendos të instaloj sistemin e vëzhgimit me kamerë, duhet të ketë parasysh që hapi i parë për zbatimin e përdorimit të sistemit të vëzhgimit me kamerë është të identifikohet qartë qëllimi ose qëllimet për ta bërë këtë, i cili duhet të jetë në proporcion me liritë dhe të drejtat e subjektit të të dhënave dhe të shërbejë për sigurinë e njerëzve, sigurimin e pasurisë apo dokumenteve konfidenciale. Bazuar në dispozitat e lartpërmendura, kontrolluesi ka të drejtë të instaloj sistemin e vëzhgimit me kamerë për të vëzhguar hyrjet e ndërtesave ose ku, për shkak të natyrës së punës së tyre, ekziston kërcënim potencial ndaj të punësuarve, që nënkupton se në raste të caktuara kontrolluesi mund të instaloj sistemin e vëzhgimit në ambientet e punës nëse ekziston rreziku potencial ndaj punonjësve. Sallat e ligjërimit (klasat) në shkolla, konsiderohen ambiente të punës së mësimdhënësve dhe kontrolluesi përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë në ambiente të punës duhet ta arsyetoj me qëllimin e vendosjes. Gjatë procesit të inspektimit, kontrolluesi nuk ka dëshmuar se ekziston ndonjë rrezik potencial ndaj të punësuarve apo pronës që do të arsyetonte vendosjen e kamerave me të cilën do të arsyetonte edhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale. Agjencia, gjatë shqyrtimit të lëndës, ka marrë për bazë edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), ku ndër të tjera, kjo gjykatë ka specifikuar se: “Amfiteatrot universitare janë vendet e punës së mësimdhënësve. Është vendi ku ata jo vetëm i mësojnë studentët, por edhe ndërveprojnë me ta, duke zhvilluar kështu marrëdhëniet e ndërsjella dhe duke ndërtuar identitetin e tyre shoqëror”. [shih Antonović dhe Marković kundër Malit të Zi, rasti nr. 70838/13, paragrafi 44]. Në kuptim të kësaj, sipas interpretimit të kësaj Gjykate, mbikëqyrja me video e një punonjësi në vendin e punës, qoftë e fshehtë apo jo, duhet të konsiderohet si ndërhyrje në jetën private të punonjësit dhe kjo përbën shkelje të nenit 8 (e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu vendosja e vëzhgimit me kamerë në hapësirën para tualeteve (në hapësirat e llavamanit) konsiderohet përpunim i të dhënave personale, dhe vendosja e kamerave në atë hapësirë ndikon në privatësinë e të punësuarve dhe nxënësve, pasi që edhe pse kjo hapësirë është jashtë tualeteve subjektet e të dhënave kanë pritshmëri për privatësi në këtë hapësirë. Vendosja e kamerave në këtë hapësirë konsiderohet se është jo proporcionale me qëllimin e vendosjes.

Agjencia për informim dhe Privatësi konsideron Kolegji Universum në Ferizaj, në cilësinë e kontrolluesit ka instaluar sistemin e vëzhgimit me kamerë në kundërshtim me nenin 5, nenin 76 dhe nenin 78 të LMDhP-së. Agjencia, për caktimin e vlerës së gjobës kundërvajtëse, ka marrë parasysh kriteret e përcaktuara me nenin 78 të LMDhP-së, pasi që vëzhgimi me kamerë ndalohet në hapësirat jashtë vendit të punës, veçanërisht në dhoma të ndërrimit, ashensorë, hapësira sanitare dhe në hapësira pune me potencial të shkeljes së privatësisë së të punësuarve dhe në këtë rast lartësia e gjobës është e vendosur në harmoni me nenin 99, paragrafin 1 të LMDhP-së.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi për t’iu shmangur sanksioneve të tilla në të ardhmen të përpunoj të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas inspektimit të kryer dhe vërtetimit të gjendjes faktike, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 23.12.2024]

Zyrtar për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Kolegjit Universum
2. Arkivit të Agjencisë.